LIGJ
Nr. 166/2014

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 3 TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS "PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 3 i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës "Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2014

Shpallur me dekretin nr. 8867, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani

Marrëveshje e Ndihmës së USAID-it
Nr. 182-DOAG-13-004

AMENDIM NUMËR TRE
I MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJES SË MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME
Datë 30 shtator 2013

Amendim numër tre i Marrëveshjes së Ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë quajtur "Përfituesi i Ndihmës").

Neni 1
Qëllimi i Amendimit

Ky Amendim numër tre i Marrëveshjes së Ndihmës të USAID-it për objektiva zhvillimi i datës 30 shtator 2013 ("Marrëveshja") bëhet ndërmjet palëve, me qëllim që t'i japë përfituesit të ndihmës një ndihmë shtesë prej pesë milionë e pesëqind e njëzet e katër mijë dollarë amerikanë (USAID) ($5,524,000) dhe të ndryshojë buxhetin në përputhje me sa më sipër. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën e angazhuar të Marrëveshjes deri në këtë datë, në një shumë që nuk kalon gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USD)($16,837,953).

Neni 2
Kontributet e palëve

Neni 3, seksioni 3.1 (a) i Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosur në këtë marrëveshje, USAID-i në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, të ndryshuar, i jep përfituesit të ndihmës sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USAID) ($16,837,953) (Granti).

Neni 3
Plani financiar

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimi të zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"III. Plani financiar

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe rezultateve paraqitet në tabelën më poshtë.

Nr.	Fusha e programit	Vitit fiskal (VF) 2013	Viti fiskal (VF) 2014	Totali VF 2013-FY 2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	$2,189,000	$1,750,000	5,339,000
2	Qeverisja e mirë	$4,557,662	$3,014,000	12,345,662
3	Shoqëria civile	$0	$60,000	1,000,000
4	Tregtia dhe investimet	$500,000	$0	1,500,000
5	Sektori financiar	$1,250,000	$0	1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	$1,817,000	$0	4,817,000
7	Mbështetja për programin	$1,000,291	$700,000	3,000,000
	TOTALI	**$11,313,953**	**$5,524,000**	**29,951,662**

Neni 4
Rregullat dhe kushtet e tjera

Përveç amendimeve në këtë dokument, të gjitha rregullat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten

plotësisht në fuqi. Të gjitha termat me germa kapitale në këtë Amendim numër tre do të kenë kuptimet që u jepen në marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky Amendim numër tre i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
Nga:_____
Datë:_____
Emri: Marcus Johnson
Pozicioni: Përfaqësuesi i USAID/Shqipëri

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Nga:_____
Datë:_____
Emri: Shkëlqim Cani
Pozicioni: Ministër i Financave